

VENDIM
Nr. 434, datë 22.6.2022

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR,
TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË “DEUTSCH-ALBANISCHE SCHULE” (DAS),
KU MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN GJERMANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, të arsimit të mesëm të lartë “*Deutsch-Albanische Schule*” (DAS), me kohë të plotë, i cili ushtron veprimtarinë arsimore në adresën: rruga “Xhanfize Keko”, kompleksi “Xhurra”, 1005, Tiranë. Në këtë institucion arsimor mësimi zhvillohet në gjuhën gjermane, ndërsa lëndët: “Gjuhë shqipe”, “Letërsi”, “Histori e kombit shqiptar” dhe “Gjeografia e Shqipërisë” zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit të mesëm të lartë “*Deutsch-Albanische Schule*” (DAS) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj